

Bakterie ESBL-formuese, informatë për pacientë

Pse e kam marrë këtë informacion?

Disa analiza kanë treguar se ti ke një bakterie që është rezistente (ka fuqi rezistuese) ndaj antibiotikëve. Në këtë fletë informative mund të lexosh më shumë mbi atë se çka do të thotë kjo dhe çka duhet të kesh parasysh që të mos infektosh njerëz tjerë.

Çka është bakteria ESBL-formuese?

ESBL do me thënë Extended Spectrum Betalactamas. Kjo është një lëndë që gjendet te disa bakterie dhe që bën që ato të bëhen rezistente ndaj disa antibiotikëve.

Bakterie ESBL-formuese mund të gjenden në zorrë si një pjesë normale e florës së baktereve në zorrë por nga të cilat nuk sëmuremi. Kjo quhet të jesh bartës. Si dhe bakteret tjera mundet që edhe bakteret ESBL-formuese nganjëherë të shkaktojnë infeksione, si për shembull infektion të kanaleve të urines.

Bakteriet me ESBL nuk shkaktojnë infektive tjera ose infektive më serioze se sa bakteret e zakonshme, mirëpo në trajtim të infeksionit duhet që të përdoren lloje të veçanta të antibiotikëve.

Si infektojnë bakteret ESBL-formuese?

Bakteret ESBL-formuese mund të infektojnë ndërmjet njerëzve nëpërmjet duarve që janë të ndotura me baktere të zorrëve, si për shembull pasi të dalim nga wc. Mund të infektoheni edhe nëpërmjet ushqimit dhe ujit.

Një person që është vetëm bartës i bakterieve ESBL-formuese në zorrë rrallëherë përhap infeksionin. Në disa situata të caktuara sasia e baktereve shtohet dhe atëherë rritet edhe rreziku për të përhapur infeksionin. Kjo quhet faktor rrezikues për përhapje të infeksionit.

Faktorë rrezikues për përhapje të infeksionit për shembull, mund të jenë:

- diarreja
- katetrat ose stomit
- plagë të hapura.

A mund të shërohem nga bakteret ESBL-formuese?

Kohëzgjatja që bartim bakterie ESBL formuese në zorrë mund të dallojë prej disa muajve e deri te disa vite. Nuk mund të thuhet sakësisht sa kohë do të barten bakteret, mirëpo shumica e njerëzve shërohen nga to me kalimin e kohës. Në të shpeshtën e herave nuk ka nevojë të bëhen kontrollat të jashtëqitjes.

Çka duhet të kem parasysh që të mos infektoj të tjerë?

Gjëja më e rëndësishme që ti mund të bësh është të jesh i kujdesshëm me higjienë të duarve. Nëse nuk ke faktorë rrezikues, rreziku është i vogël që ti të infektosh prandaj ti mund të shoqërohesh me të tjerë si zakonisht. Ti mund edhe të kesh marrëdhënie seksuale si zakonisht. Mund poashtu të punosh si zakonisht. Fëmijët mund të vijojnë parashkollën dhe shkollën dhe të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet.

Rutina të posaçme higjenike për ty me faktorë rrezikues

Nëse ke faktorë rrezikues për përhapje të infeksionit, rreziku është më i madh që ti të përhapësh infeksionin. Atëherë ti duhet të kesh parasysh gjërat në vijim:

- Të jesh i kujdesshëm me larjen e duarve. Përdor peshqir dhe artikuj tuaj higjenikë.
- Mos u laj në pishinë njëkohësisht me të tjerët.
- Mbulo plagët me fashë dhe ndërro fashën nëse lëngu depërton në sipërfaqe.
- Nëse ke katetër atëherë ato duhet ti kesh nën rroba.
- Laj duart pas kontaktit me plagët, fashën ose katetrën.

A duhet t'u tregoj të tjerëve që jam bartës?

Nuk je i detyruar t'u tregosh të tjerëve në rrethin tuaj që ti je bartës i baktereve ESBL- formuese.

Në rast se të duhet të trajtohesh me antibiotikë është shumë me rëndësi që ti të marrësh llojin adekuat të antibiotikëve. Para trajtimit duhet poashtu që të merret një mostër bakteriesh. Për hir tuajin, ne të lutemi t'i tregosh mjekut tënd se ti je bartës i bakterieve ESBL- formuese.

Mbi fletën informative për mbrojtje nga infeksioni

Fleta informative për mbrojtje nga infeksioni është përpiluar nga shoqata e mjekëve për mbrojtje nga infektimi dhe vlen për tërë vendin.